




**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**



**KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik  
Uprava za Ekonomski Razvoj/Department for Economy Development  
Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

Data/Datum/Date:	18.11.2022
Nr./Br./No	04/32
Për/Za/To:	Kastriot Shabani, Drejtor i Drejtoris për Zhvillim Ekonomik
Nga/Od/From:	
Lënda/Predmet/Subject :	Raporti i punes per vitin 2022

Kemi perfunduar projektin nenshkruar per bashkpunim me IADK per vitin 2020-2022, bazuar ne projektin „, Permirsimi i punesimit dhe mundesive per gjenerim te te ardhurave ne zonat rurale te Kosoves, ku kete vit kemi perkrahur 17 përfitues.

Projekti do te arrij rezultate te prekshme me perkrahjen e te rinjeve me keshilla praktike dhe teorike me qellim punesimi dhe gjenerimite te ardhurave dhe me grande per vetepunesim.

Do te trajnohen dhe aftesohen gra ne fushen e perpunimit dhe do te qertifikohen dhe do te perkrahen ne ngritjen e pikes perpunuse (fruta, perime, embelsira) dhe do te punesohen edhe gra tjera.

I gjithe projekti do te perkrahet ngaa IADK, Komuna Shtime dhe perfitusit.

-Jemi ne pritje te nenshkrimit te kontrates per trajtimin e geneve endacak, ku me kete projekt jan parapare te trajtohen 118 qene endacak, ku parashihet te behet kastrimi, dehelmetizimi dhe matrikulimi i tyre.

- Kemi përfunduar nje fazë në projektin e Rregullimit te rrugëve bujqësore me zhavor, ku me këtë projekt jan shtruar me zhavor 8.7 km, në pjesën e dytë të vitit kemi filluar edhe me 3 km tjera rruge bujqësore ne fshatrat Muzeqine, Gllavice, Vojnovec dhe Mullopolc

Po ashtu jemi perfitues të projektit nga MBPZH R për Rregullimin e kanaleve kulluse qe fillon nga fshati Godanc dhe perfundon ne fshatin Gjurkovic.

-Sektori për Bujqesi për çdo vit bënë planifikimin për mbjelljet pranverore, edhe këtë vit në komunën jan mbjellur kultura të ndryshme pranverore, ku zakonisht dominon kultura e misrit me siperfaqen më të madhe.



Po paraqesim në formë tabelare kulturat e planifikuar dhe siperfaqën për vitin 2022:

Nr rendor	Kultura	Sipërfaqet e planifikuara për mbjellje / ha
1	Misër kokërr	900
2	Misër me fasule	50
3	Misër i gjelbërt	60
4	Elb	10
5	Tërrëshër	50
6	Bimë furragjere	20
7	Bimë industriale	3
8	Perime në serra	7
9	Perime në fushë të hapur	40
10	Patafe	20
11	Fasule monokulturë	10
	<b>Gjithësejt</b>	<b>1180</b>

-Pranimi i aplikacioneve te fermereve per subvencione per pagesa direkte te fermereve thirrje e shpallur nga MBPZHR nga data 26.04.2022 deri më 1.5.2022, ku gjae kësaj periudhe kan aplikuar afer 500 fermere, kemi dorezuar dosjet e tyre ne AZHB, ku i janë nënshtruar kontrollit administrativ dhe kontrollit te terenit nga ana e zyrtareve te AZHB së, këtyre ditëve kur po raportojm u janë egzekutuar edhe pagesat.

Kemi implementuar Marreveshjen e Bashkpunimit me Help- in, ku nga kjo marreveshje kan perfituar 35 përfitues, që kan përfituar paisje në vlerë prej 2000 euro.

Kemi nënshkruar marrëveshje bashkpunimi me OZHR Mushtjerra, për përkrahjen e 13 fermerëve me nga 10 dhi te racës Alpina, në këtë projekt kemi pasur 28 aplikues.

Kemi shpallur thirrjen për aplikim per 40 serra për fermerët e komunës së Shtimës, për serra me nga 50 m<sup>2</sup>, në të cilën thirrje kan aplikuar 214 aplikues, komisioni për ndarjen e serrave ka dal në teren dhe këto ditë pritet shpallja e fituseve.

-Pjesmarrja e zyrtarit per keshillime, ne trajnimet e organizuara nga MBPZHR dhe ILO, per ngritjen e kapaciteteve te keshilltareve publik.

Pjesmarrja ne komisionin per vlersim te demeve nga fatekeqesit natyrore dhe demet e shaktuar agjate - ndertimit te kolektorit te ujравe te zeza, ku se bashku me antaret tjere te komisionit kemi bere vlersimin e demit dhe një rapor të fundit komisioni e ka hartu dhe ka bërë dorzimin në MBPZHR, për kompenzim të dëmeve që u jan shkaktuar fermerëve nga fatkeqesit natyrore.

-Kemi pranuar dhe shqyrtau pese (10) kerkesa te paleve ku gjashtë (6) prej tyre kan qene per shendrrim toke bujqesore ne ndertimore dhe jan inkasuar 5789 euro.